ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA PARTESH**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**658-24-7751-5-2-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **"RI-TENDER: Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh. budrig e ulët".**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Dua arch SH.P.K & Pro&Co Group&NNT ABC&NNT Bini SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Sheshet Kadri Zeka, p.n
(Adresa)

Gjilan ***60* 000**

(Vendi) *(Kodi postar)*

+383 48 500339

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Drenushë Ukshini

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

drenushukshini@gmail.com
(Adresa elektronike)

03.04.2025
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K "DUA ARCH" GJILAN

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 29.07.2024 Njoftimi mbi vendimin dt.06.11.2024 Kërkesa për rishqyrtim: 11.11.2024 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 18.11.2024 Ankesa në OSHP: 22.11.2024 Vendimi OSHP-së nr.1144/24: 23.01.2024 Njoftimi mbi vendimin dt.19.03.2025 Kërkesa për rishqyrtim: 24.03.2025 Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 01.04.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 10 i LPP-së** **Neni 11 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 60 i LPP-së** **Neni 69 i LPP-së** **Neni 72 i LPP-së** **Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik** **Neni 10 i Udhëzuesit Për Prokurim Publik Nr.001/2023** **Vendimi i OSHP-së Nr.2024/1144 i dt.23.01.2025.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kronologji:

Njoftimi për kontratë është publikuar me dt. **29.07.2024**, kurse njoftimi i parë mbi vendimin e AK-së B58 është publikuar me dt.11.11.2024, ku është rekomanduar për kontratë **Jana SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K. Enver Miftari p.n, Gjilan,** kurse neve na ishte dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar. Ne me 11.11.2024 kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së e cila e kishte refuzuar si të pabazuar. Pastaj më 22.11.2024 kemi parashtruar ankesë pranë OSHP-së, e cila me Vendimin nr. 2024/1144 e kishte aprovuar ankesën tonë si të bazuar dhe kishte kthyer lëndën në rivlerësim.

Pas rivlerësimit, AK-së më 19.03.2025 ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin B58, ku përsëri është rekomanduar për kontratë **Jana SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K. Enver Miftari p.n, Gjilan,** kurse neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Grupi Operatoreve Ekonomik DUA ARCH SHPK & PRO&CO GROUP SH.P.K&NNT ABC& NNT BINI nuk i plotëson kriteret e percaktuara në Njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, sepse ne dosje te tenderit kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale tek kërkesa mbi makinerit, paisja me nr. 12 (Eskavator me luge ngarkuese para dhe prapa 2 copë), GOE ka dorëzuar një faturë me nr. 29-04-2016 ne gjuhën gjermane e cila është në kundërshtim me nenin 13, pika 4 të LPP Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit te prokurimit, në gjuhën Shgipe, Serbe ose në gjuhën Angleze. Andaj, oferta juaj vlerësohet si e papergjegjshme nga komisioni i Ri- vlerësues.

Ju nuk keni dorëzuar librezen e qarkullimit për mjetin sipas kërkesës së AK-së 9).Damper mbi 3 ton - 1 cope. Ju nuk keni ofruar libreza e qarkullimit me rexhistrim validet por keni ofruar nje Faturë të dates 18.10.2019 me numer 606/19 DUDIN me numër R 8573 të dates 15.04.2019 për makineri Wacker Neuson,Modeli 5001,Viti i prodhimit 2000. Që nuk dëshmon rregullsine teknike dhe regjistrimin e 9).Damper mbi 3 ton - 1 cope. ashtu siq kerkohet ne LIGJIN NR. 05/L-132 PER AUTOMJETET dhe UDHÉZIMIN ADMINISTRATIV (MPB) NR.01/2018, PER REGISTRIMIN E MIETEVE.
Lidhur me oferten e juaj komisioni i vlersimit dhe ekzaminimit te ofertave ka konstatuar se ju nuk keni arritur te plotesoni Kërkesen sipas nenit 9.1&9.2 të FTD-së

për arsye Ju nuk keni dorëzuar librezen e qarkullimit për mjetin sipas kërkesës së AK-së 12).Eskavator me luge ngarkuese para dhe mbrapa - 2 cope. Ju nuk keni ofruar libreza e qarkullimit me rexhistrim validet por keni ofruar nje DUD për makineri CAT,Modeli 428E,KW:67,Viti i prodhimit 2007. Që nuk dëshmon rregullsine teknike dhe regjistrimin e Eskavator me luge ngarkuese para dhe mbrapa ashtu siq kerkohet ne LIGJIN NR. 05/L-132 PER AUTOMJETET dhe UDHÉZIMIN ADMINISTRATIV (MPB) NR.01/2018, PER REGISTRIMIN E MIETEVE.

Sa i përket arsyes së eliminimit për damper mbi 3 ton dhe për eskavator me lugë ngarkuese që nuk janë të regjistruar, ju sqarojmë se këto makineri nuk janë obligative të regjistrohen, prandaj nuk mund të eliminohemi për një kërkesë që nuk është obligative.

Sa i përket ligjit që është cekur dhe udhëzimit administrativ, sqarojmë se askund në këtë ligj dhe udhëzim administrativ nuk shkruan se janë obligative regjistrimet për këto pajisje, prandaj vetëm janë cekur këto ligje.

Për më tepër ky projekt ka të bëjë me rregullim të shtratit të lumit dhe nuk ka të bëjë me rrugë dhe asfaltim të rrugëve, kështu që këto pajisje nuk duhet të lëvizin nëpër rrugë.

Arsyet e eliminimit janë trajtuar edhe në OSHP ku me vendimin PSH.Nr.2024/1144 i dt.23.01.2025 është konstatuar se ne jemi eliminuar padrejtësisht, prandaj kjo arsye e eliminimit është çështje e gjykuar Res Judicata sipas nenit 105 par. 2016 të LPP-së.

Sa i përket arsyes së eliminimit se kemi ofruar një faturë në gjuhen gjermane, sqarojmë se ky dokument bënë pjesë në dispozitat e nenit 65-71, e që në këto raste lejohen të kërkohen sqarime sipas nenit 72 të LPP-së. Këtë situatë e ka qartësuar edhe interpretimi i KRPP tek pyetja Nr.7, ku ndër të tjera ceket *"Ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohet nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument".*

Në këtë rast lejohet të kërkohen sqarime dhe AK-ja është dashur të kërkojë sqarime pavarësisht se fatura është një dokument që mund të kuptohet lehtë pothuajse në cilën do gjuhë.

Pavarësisht kësaj dispozite, në këtë rast nuk ka nevojë të kërkohen sqarime shtesë sepse fatura nuk përbën ndonjë relevancë sepse me dosje të tenderit është bashkangjitur urdhërpagesa në gjuhen shqipe për eskavator (skip) me lugë ngarkuese para dhe prapa e dt.10.05.2024, prandaj kjo dëshmi është relevante dhe e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Mbi këtë bazë sqarojmë se ne jemi eliminuar padrejtësisht në këtë aktivitet të prokurimit.

Pas pranimit të njoftimit mbi vendimin përkatësisht formularit B58, ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e grupit të OE të rekomanduar për kontratë, mirëpo përsëri nuk na është lejuar qasje e plotë në dokumentet e këtij grupi të OE.

Me qasje na është dorëzuar një kërkesë për sqarime e dt.25.02.2025 dërguar grupit të OE të rekomanduar për kontratë, ku sqarimet janë kërkuar si më poshtë:

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

Në lidhje me aktivitetin e Prokurimit " *RI-TENDER ;Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh. budrig e ulët"*

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

Tek Kapaciteti teknik dhe financiar: Kërkesa 1. Kerkesa 1 OE duhet te kete se paku ne tri vitet e fundit qarkullim ne shumen prej 350.000,00 Euro. Kerkesa 2 OE duhet te kete te pakten 50.000,00 Euro asete likuide ne llogarin bankare ose qasje per kredi nga ndonje banke.

Deshmia 1 Deklarata nga ATK ose raport financiar. Deshmia 2 Deklarata nga banka qe verteton disponueshmerin ne llog. bankare ose vertetim bankar qe kompania mund te marr kredi deri ne shumen e lartecekur.

Komisioni profesional për Egzaminimin dhe Vlerësimin e Ofertave kërkon sqarim ne oferten tuaj lidhur me letërperkrahjen që e keni dorëzuar së bashku me ofertë. Aty ceket se "banka do të shqyrtojë financimin e aktivitetit në fjalë në procedurat e saj të brendshme". Ndërsa sipas kërkesës së dosjes së tenderit ka qenë që ju të dorëzoni deklaratë nga banka që vërteton disponueshmërinë në llogari OSE vertëtim bankar që kompania mund të merr kredi në shumën e lartëcekur.

Që te vlerësojmë në mënyrë të duhur ofertën tuaj ju lutem na sqaroni se ju si GOE JANA SH.P.K & EL-BAU SH. P.K se a keni poseduar mjete te gatshme në llogari bankare sipas kërkeses së lartëcekur.

Sqarimet janë kërkuar, mirëpo përgjigjet dhe dëshmitë të cilat janë ofruar nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk na janë dhënë me qasje në dokumente, duke u arsyetuar se dokumenti nga banka është sekret afarist i përcaktuar sipas aneksit 3. Në lidhje me këtë çështje ekspertja shqyrtuese e edhe paneli shqyrtues e kishte konstatuar se deklarata nga Banka nuk është sekret afarist, prandaj në këtë rast nuk është respektuar edhe vendimi i panelit shqyrtues PSH.Nr.**2024/1144 i dt.23.01.2025.**

Nuk është respektuar neni 10 i LPP-së e po ashtu edhe neni 11 i LPP-së sepse nuk është arsyetuar deklarata për sekret afarist, e po ashtu AK-së nuk ka përgatit versionin e pastruar në lidhje me dokumentet e konsideruara sekret afarist nga ana e grupit të OE të rekomanduar për kontratë.

Ligjërisht nuk mund të kërkohen sqarime për këtë çështje-dokument të Bankës, sepse grupi i OE të rekomanduar për kontratë me dosje të tenderit ka bashkangjitur një dokument nga Banka, e cili nuk i ka përmbush kërkesat e dosjes së tenderit, prandaj çfarëdo dokumenti që është ofruar më pastaj me sqarime nuk mund të merret parasysh sepse sqarimi i kërkuar është i kundërligjshëm.

Se deklarata nga Banka nuk ka qenë sipas kërkesës e ka konstatuar edhe ekspertja shqyrtuese dhe këtë konstatim e ka mbështetur paneli shqyrtues në vendimin PSH.Nr.**2024/1144 i dt.23.01.2025, duke e konsideruar të papërgjegjshëm këtë grup të OE.**

Megjithatë sqarojmë se ky grup i operatorëve ekonomik është i papërgjegjshëm me arsyet si në vijim.

- Grup i Operatorëve Ekonomik **Jana SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K** është i papërgjegjshëm me arsyet si më poshtë:

Kerkesa 1 OE duhet te kete se paku ne tri vitet e fundit qarkullim ne shumen prej 350.000,00 Euro. Kerkesa 2 OE duhet te kete te pakten 50.000,00 Euro asete likuide ne llogarin bankare ose qasje per kredi nga ndonje banke.

Deshmia 1 Deklarata nga ATK ose raport financiar. Deshmia 2 Deklarata nga banka qe verteton disponueshmerin ne llog. bankare ose vertetim bankar qe kompania mund te marr kredi deri ne shumen e lartecekur.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi që ka të disponueshme shumën prej 50,000.00 euro ose vërtetim bankar që kompania mund të merr kredi në shumën e lartcekur, por i njëjti grup i OE ka ofruar letër përkrahje e cili nuk është aprovim kreditor por është vetëm një letër e cila i sqaron procedurat e përkrahjes së subjekteve juridike, e që kjo letër i lëshohet secilit OE që e kërkon, e ku sqarohet se nëse kërkon mbështetje financiare do të shqyrtohet financimi, prandaj është dashur të eliminohet nga konkurrenca.

Gjithashtu në dyshojmë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka vazhduar me kohë validitetin e ofertave dhe sigurimin e tenderit, prandaj kërkojmë që të sqarohet ky pretendim i yni i cili ngritet mbi bazën e dyshimeve pasi që nuk na është dhënë qasje e plotë në ofertën e grupit të OE të rekomanduar për kontratë.

- Grup i Operatorëve Ekonomik **KUSHTRIMI NM SH.P.K.; AGRO INVEST 1 SH.P.K.; Xhemshir Sejdija B.I.** është i papërgjegjshëm sepse diplomën dhe kontratën e punës për inxhinierin Skender Cakja e ka ofruar të pa Noterizuar, prandaj është i papërgjegjshëm.

Për inxhinierin e ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv **Zymer Gaga** është ofruar kontrata e punës e pa Noterizuar, prandaj është i papërgjegjshëm ky grup i OE.

Për inxhinierin e hidroteknikes z.Sadik Pllana është ofruar kontrata e pa Noterizuar, prandaj është i papërgjegjshëm ky grup i OE.

Po ashtu edhe për inxhinierin e Gjeodezisë është ofruar kontrata e punës e pa Noterizuar prandaj është i papërgjegjshëm ky grup i OE.

Në dosje të tenderit tek neni 9.1&9.2 i FDT-së tek kërkesat tekniko profesionale ne piken (n) është kërkuar certifikatë për menaxhimin e mjedisit ne punishte, kurse grupi i OE në fjalë ka ofruar një certifikatë për z Kushtrim Misini e cila është ISO STANDARD 14001;2015 për sistem të menaxhimit të mjedisit, mirëpo askund nuk shkruan se është për menaxhim të mjedisit në punishte, e që realisht kjo dëshmi nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, prandaj ky grup i OE është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.

Në dosje të tenderit është kërkuar certifikatë, kurse ky grup i OE ka ofruar iso standard.

Po ashtu i njëjti grup nuk ka vazhduar sigurimin e tenderit.

Po ashtu pajtohem me arsyen e eliminimit të këtij grupi të OE, që e ka cekur AK-së në vlerësimin e kaluar, si në vijim:

JU për ta plotësuar këtë kërkesë të kërkuar në Dosjen e tenderit dhe Njoftimit për Kontrate ,keni dorëzuar deklaratat nën betim por që Tre Anëtaret e Grupit kanë përdorur Ankesin 2. i

cili i referohet aktivitetit me titull- Rregullimi i shtratit të lumit në fsh. budrig e ulët ,me numër të prokurimit -658-24-6178-5-2-1, e jo aktivitetit për të cilin keni ofertuar e i cili mban këtë titull : RI-TENDER ;Rregullimi i shtratit të lumit në fsh. budrig e ulët , dhe këtë me numër të prokurimit : 658-24-7751-5-2-1 . Bazuar në këtë të gjetur dhe meqenëse Deklarata nën Betim është kusht administrativë , komisioni vlerëson se ky GOE-ve nuk e kanë plotësuar këtë kusht administrativë.

Pra edhe kjo arsye e eliminimit është edhe pretendim i yni ankimor.

Gjithashtu i njëjti grup nuk ka vazhduar edhe validitetin e ofertave.

- Grup i Operatorëve Ekonomik **Eco Holding Group SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K është i papërgjegjshëm me arsyet si më poshtë:**

Në dosje të tenderit tek neni 9.1&9.2 i FDT-së tek **kërkesat tekniko profesionale** ne piken **(e)** është kërkuar personel i certifikuar për gdhendje dhe muratim te gurëve, ndërsa grupi i OE në fjalë për këtë kërkesë ka prezantuar një certifikatë për z Shpetim Sahiti i certifikuar për Muratim me tulla dhe Blloqe dhe materiale për muratim, prandaj kjo certifikatë nuk e plotëson kërkesën e cekur më lartë dhe për këtë arsye është dashur të eliminohet nga konkurrenca ky grup i OE.

Kerkesa 1 OE duhet te kete se paku ne tri vitet e fundit qarkullim ne shumen prej 350.000,00 Euro. Kerkesa 2 OE duhet te kete te pakten 50.000,00 Euro asete likuide ne llogarin bankare ose qasje per kredi nga ndonje banke.

Deshmia 1 Deklarata nga ATK ose raport financiar. Deshmia 2 Deklarata nga banka qe verteton disponueshmerin ne llog. bankare ose vertetim bankar qe kompania mund te marr kredi deri ne shumen e lartecekur.

Grupi i OE në fjalë nuk ka ofruar dëshmi që ka të disponueshme shumën prej 50,000.00 euro ose vërtetim bankar që kompania mund të merr kredi në shumën e lartcekur, por i njëjti grup i OE ka ofruar letër përkrahje e cili nuk është aprovim kreditor por është vetëm një letër e cila i sqaron procedurat e përkrahjes së subjekteve juridike, e që kjo letër i lëshohet secilit OE që e kërkon, e ku sqarohet se nëse kërkon mbështetje financiare do të shqyrtohet financimi, prandaj është dashur të eliminohet nga konkurrenca.

Po ashtu i njëjti grup nuk ka vazhduar sigurimin e tenderit.

- Grup i Operatorëve Ekonomik Euro Commerc; **ARLINDI SHPK; LEDI SH.P.K.** - RI-TENDER ;Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh. budrig e ulët **është i papërgjegjshëm me arsyet si më poshtë:**

Në dosje të tenderit tek neni 9.1&9.2 i FDT-së tek kërkesat tekniko profesionale ne piken (n) është kërkuar certifikatë për menaxhimin e mjedisit ne punishte, kurse grupi i OE në fjalë ka ofruar një certifikatë për z Fatlind Musa e cila është ISO STANDART 14001;2015 edhe për auditor, mirëpo askund nuk shkruan se është për menaxhim të mjedisit në punishte, e që realisht kjo dëshmi nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit , prandaj ky grup i OE është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.

Në dosje të tenderit është kërkuar certifikatë, kurse ky grup i OE ka ofruar iso standard.

Grup i Operatorëve Ekonomik Euro Commerc; ARLINDI SHPK; LEDI SH.P.K., Viti, nuk ka vazhduar validitetin e ofertës prandaj edhe për këtë arsye është i papërgjegjshëm.

Të tre grupet e OE të lartcekur janë shpallur të papërgjegjshëm edhe me vendimin PSH.Nr.**2024/1144 i dt.23.01.2025, prandaj këto pretendime janë Res Judicata për tre OE e lartpërmendur dhe për grupin e OE të rekomanduar për kontratë sepse me vendim të OSHP- janë konfirmuar papërgjegjshmëritë e këtyre grupeve të operatorëve ekonomik.**

Ne me dt.01.04.2025 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së, ku e njëjta e ka cilësuar kërkesën tonë si të pa bazuar, mirëpo që arsyetimin e saj nuk e ka mbështetur në fakte dhe dispozita konkrete ligjore.

Autoriteti kontraktues në lidhje me pretendimin tonë ankimor sa i përket pajisjeve ka dhënë përgjigjjen si në vijim:

> Sa i përket pretendimit tuaj ankimor, AK konstaton se sipas letres standarde të eliminimit ku ju kemi cekur se për mjetet që i nënshtrohen regjistrimit ju nuk keni ofruar këto paisje të regjistruara siq kërkohet me Ligjin 05/L-132 per automjetet dhe Udhëzimin Administrativ MPB nr. 01/2018 për regjistrim të automjeteve.
>
> Ndërsa sa i përket konstatimit nga ana e juaj se këto mjete nuk regjistrohen, nuk qendron sepse sipas nenit 39, pika 3 (Në trafikun rrugor **nuk mund të marrin** pjesë mjetet e paregjistruara si motokultivatori dhe mjetet e punës. ***Nëse këto mjete marrin pjesë në trafikun rrugor duhet të jenë të regjistruara dhe t'i kenë sistemet dhe pajisjet e përcaktuara teknikisht në rregullt).***
> Ndërsa OE i shpallur fitues për të plotësuar kërkesën e DT dhe NJK këto paisje i ka ofruar me regjistrim valid duke dëshmuar rregullsinë e tyre teknike. Andaj, pretendimi juaj është i pabazuar.

Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se siç e kemi sqaruar edhe më lartë makineritë e kontestuara nga AK nuk janë obligative të regjistrohen. Ky pretendim i yni ankimor është çështje e gjykuar Res Judicata sipas nenit 105 par. 2016 të LPP-së, sepse e njëjta është trajtuar në vendimin PSH.Nr.2024/1144 të dt.23.01.2025, ku është konstatuar se ne jemi eliminuar pa ndonjë të drejtë ligjore nga ana e AK-së. Andaj në këtë rast nuk mund dhe nuk është dashur të eliminohemi me një arsye të tillë përderisa vet OSHP-ja e ka vërtetuar faktin se ne jemi eliminuar padrejtësisht nga ky aktivitet i prokurimit.

Gjithashtu ne edhe një herë po e sqarojmë se në ligjin Nr.05/L-132 për Automjete, nuk është e obligueshme që pajisjet të cilat përdoren **vetëm në kantier të regjistrohen.**
Kur kemi parasysh dëshminë e kërkuar dokumentare tek dosja e tenderit dhe duke u bazuar në nenin 9, paragrafi 1.2 i Ligjit Nr.05/L-132 për Automjete, **makineritë që janë të dedikuara për përdorim në kantier ndërtimi janë të përjashtuara nga homologimi dhe rrjedhimit, nga regjistrimi i detyrueshëm.**
Pra sipas legjislacionit në fuqi përkatësisht Ligjit Nr.05/L-132 për Automjete:
-Dudat doganorë,
-Librezat e automjeteve për makinerinë që kanë nevojë për kyçje në komunikacion,
-Dokumentacionin për makineritë punuese dhe pajisje të tjera, që janë të përjashtuara nga regjistrimi sipas legjislacionit në fuqi.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura, ne për makineritë të cilat nuk janë të obligueshme të regjistrohen kemi prezantuar dëshmitë sipas kërkesës, andaj në asnjë mënyrë arsyetimi i

autoritetit kontraktues për eliminimin dhe refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk është i qëndrueshëm.

Për pretendimin tonë ankimor në lidhje me arsyen e eliminimit tonë për faturën në gjuhën gjermane AK-ja ka dhënë arsyetimin si në vijim:

Ndërsa pretendimi juaj se fatura nuk përbën ndonjë relevancë nuk qëndron sepse në DT dhe NJK është kërkuar qartë se *Deshmia 1. per te gjitha paisjet qe rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronsin e tyre , libreza e qarkullimit me rexhistrim valid, per paisje qe nuk rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronesin (kontrat e blerjes,fature ose Dud doganor. Nese ka marveshje huazimi marveshja duhet te jete e nenshkruar dhe vulosur nga dy palet dhe e noterizuar . Pra sikur të kishte ekzistuar dokumenti lidhur me faturën në njërën nga gjuhët zyrtare sipas LPP-së, të njejtën është dahsur të bashkangjitni në ofertë apo në kërkesën për rishqyrtim me datë para hapjes së ofertave dhe e njetat të ishte e noterizuar, por një të tillë ju nuk e keni ofruar në ofertën tuaj.*

Pra shihet qartë se sipas DT dhe NJK askund nuk është kërkuar që të urdhërpagesa, por është kërkuar që të ofrohet per te gjitha paisjet qe rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronsin e tyre , libreza e qarkullimit me rexhistrim valid, per paisje qe nuk rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronesin (kontrat e blerjes,fature ose Dud doganor.

Andaj, AK konstaton se pretendimi juaj është i pabazuar.

Arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se urdhërpagesa është dokument financiar që vërteton se pagesa është kryer. Përderisa është bashkangjitur urdhërpagesa në gjuhën shqipe për eskavatorin (skip) me lugë ngarkuese para dhe prapa, atëherë e njëjta është një provë e qartë dhe relevante konform kërkesës së dosjes së tenderit.
Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura, kuptohet qartë se arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm.

Tek arsyetimi tjetër për pretendimin tonë ankimor kundrejt OE të rekomanduar për kontratë sa i përket dokumentit nga banka, AK-ja përsëri është arsyetuar se dokumenti i tillë është sekret afarist, ndërsa e ka cekur se në sqarimin që OE i rekomanduar për kontratë e ka bërë, ka dëshmuar që ka mjete të gatshme në llogari bankare sipas DT.
Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se në lidhje me këtë çështje ekspertja shqyrtuese e edhe paneli shqyrtues e kishte konstatuar se deklarata nga Banka nuk është sekret afarist, prandaj në këtë rast nuk është respektuar edhe vendimi i panelit shqyrtues PSH.Nr.2024/1144 i dt.23.01.2025. Ndërsa sa i përket sqarimeve të cilat i janë kërkuar OE të rekomanduar për kontratë gjatë fazës së rivlerësimit, ju sqarojmë edhe një herë se ligjërisht nuk mund të kërkohen sqarime për këtë çështje-dokument të Bankës, sepse grupi i OE të rekomanduar për kontratë me dosje të tenderit ka bashkangjitur një dokument nga Banka, e cili nuk i ka përmbush kërkesat e dosjes së tenderit. Prandaj çfarëdo dokumenti që është ofruar më pastaj me sqarime nuk mund dhe nuk duhet të merret parasysh sepse sqarimi i kërkuar është i kundërligjshëm.

Dokumentin nga banka të cilin e kishte bashkangjitur OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij, e kishte vërtetuar edhe ekspertja shqyrtuese se deklarata nuk është sipas kërkesës dhe këtë konstatim e kishte mbështetur paneli shqyrtues në vendimin PSH.Nr.2024/1144 i dt.23.01.2025, duke e konsideruar të papërgjegjshëm këtë grup të OE. Në këtë rast AK-ja përveç se nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-së, e njëjta në çdo mënyrë po e tregon haptas favorizimin që po i bën OE të rekomanduar për kontratë edhe pse i njëjti është i papërgjegjshëm.

AK-ja nuk ka dhënë përgjigjje fare në lidhje me pretendimin tonë ankimor sa i përket dyshimeve për mos vazhdimin e validitetit dhe sigurimit të tenderit me kohë nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, andaj në këtë rast po rriten dyshimet tona se pretendimi ynë është i qëndrueshëm. Kërkojmë nga ana e panelit shqyrtues dhe ekspertit shqyrtues të OSHP-së që ti analizoj në detaje dokumentet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë, me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike.

Kur kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm për faktin se vendimi i tillë nuk është i bazuar në asnjë dispozitë ligjore dhe njëkohësisht i njëjti është në kundërshtim me vendimin e PSH.Nr.2024/1144 i dt.23.01.2025.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.
Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"*. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që *(vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"*, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha sqarimet e lartcekura dhe në dëshmitë e kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

I. **APROVOHET,** si e bazuar ankesa e **Grupi të OE Dua arch SH.P.K & Pro&Co Group&NNT ABC&NNT Bini SHPK.**

II. **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi i** ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve na janë shkaktuar dëme në vlerë rreth 5 mijë euro deri më tani.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës se eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*